

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BORDE, KËSHILLA, KOMISIONE APO ORGANE

TË TJERA KOLEGJIALE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE DHE ENTEVE

PUBLIKE

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar “Për zbatimin e kuadrit rregullator ligjor dhe nënligjor të krijimit, përbërjes dhe shpërblimit të bordeve, këshillave, komisioneve apo organeve të tjera kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.10.2013 deri me datë 30.06.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.137, datë 30.09.2015

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresat nga nr. 527/197 deri në nr. 527/215 datë 10.10.2015, dërguar të gjithë kryetareve të Bordeve, Këshillave, Komisioneve dhe Organeve të tjera Kolegjiale, Kontrolli i Lartë i Shtetit u ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME DHE PËRMIRËSIME LIGJORE.

Nga auditimi i ushtruar u konstatua se punonjës të administratës shtetërore, sidomos drejtues të niveleve të larta menaxheriale rezultojnë të angazhuar me pagesë në disa struktura kolegjiale duke mos llogaritur pjesëmarrjen e tyre në borde, komisione, këshilla apo organe të tjera pa pagesë e cila kërkon angazhimin e tyre me kohë të pjesshme.

Referuar aspektit financiar kjo kategori punonjësish përveç pagës në ushtrim të funksioneve organike përfiton të ardhura të tjera që vijnë si pasoje e angazhimit në këto struktura kolegjiale që variojnë nga 2-4 struktura apo edhe më shumë dhe në disa raste edhe në struktura të sektorit privat duke u shpërblyer me fonde të konsiderueshme në trajtën e shpërblimeve.

E trajtuar kjo çështje në aspektin e performancës në punë dhe kontributit të këtyre punonjësve është realisht e pamundur si kohë fizike por jo vetëm kaq, angazhimi njëherazi si në institucionet ku janë të punësuar, ashtu edhe në angazhimet suplementare në përbërje të bordeve, komisioneve, këshillave apo organeve të tjera kolegjiale.

Impakti në këto raste është një pjesëmarrje formale, jo funksionale, jo kontributive, pa efektivitet, dhe i vetmi përfitim janë shpërblimet e konsiderueshme monetare vetiake me pasojë abuzimin me fondet publike.

1-Mbi kufizimin e masës së shpërblimit dhe numrit të pjesëmarrjes në borde, komisione, këshilla dhe organe të tjera kolegjiale.

1.a Kuadri rregullator mbi numrin maksimal të lejueshëm të angazhimit në strukturat kolegjiale.

Nga auditimi i ushtruar në zbatimin e kuadrit rregullator ekzistues mbi krijimin përbërjen shpërblimin e bordeve/komisioneve dhe Këshillave Mbikëqyrës, rezultoi një numër i konsiderueshëm punonjësish kryesisht të nivele të larta menaxheriale (Drejtorë Kabineti të Ministrave, Këshilltarë, Sekretarë të Përgjithshëm, Drejtorë të Përgjithshëm, Zëvendës Ministra,

Drejtorë të Drejtorive etj) të angazhuar në kohë të pjesshme në cilësinë e kryetarëve/anëtarëve në borde, komisione, këshilla dhe organe të tjera kolegjiale.

Konstatohet që kjo kategori punonjësish krahas funksioneve organike në ministri/institucione qendrore rezultojnë të angazhuar me pagesë edhe në një numër të konsiderueshëm strukturash kolegjiale.

Kuadri rregullator ekzistues lejon që një punonjës i administratës shtetërore të angazhohet me kohe të pjesshme me të drejtë pagese në katër struktura kolegjiale dy borde, komisione, këshilla në institucionet qendrore dhe dy këshilla në shoqëri anonime dhe konkretisht:

Në VKM nr. 418, datë 27.06.2012 pika 4.a “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillave, bordeve, komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore” i ndryshuar me VKM 391 datë 03.04.2013 dhe VKM 621 datë 24.09.2014 përcaktohet se:

“Funksionarët politikë, nëpunësit civil, dhe punonjësit e administratës shtetërore, të cilët janë përfaqësues me të drejtë pagese në më shumë se dy këshilla, borde apo komisione të listuar në këtë vendim, përjashtohen nga e drejta e pagesës”.

Po kështu edhe në VKM nr. 642 datë 11.10.2005 i ndryshuar me VKM nr 677 datë 03.10.2007 “Për Këshillat Mbikqyrës të shoqërive anonime shtetërore” përcaktohet se: “Anëtarët e Këshillave Mbikqyrës miratohen nga Ministri i Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës dhe i njëjti person nuk mund të marrë pjesë në më shumë se dy Këshilla Mbikqyrës”.

1.b Mbi pagesat e anëtarëve të Këshillave Mbikqyrës pa marrë pjesë në mbledhje ose në një numër minimal mbledhjesh.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultuan pagesa të konsiderueshme të anëtarëve të Këshillave Mbikqyrës në shoqëritë anonime ndërkohë që këta punonjës nuk kanë marrë pjesë ose kanë marrë pjesë në një numër minimal mbledhjesh. Vetë kuadri rregullator ekzistues krizon hapësirën që një punonjës të paguhet edhe pa marrë pjesë në mbledhje, pasi në VKM nr. 642 datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikqyrës të shoqërive anonime shtetërore” në pikën 7 përcaktohet:

*“Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës është **mujor** dhe jepet nga mbledhja e parë e Këshillit. Efektet përballohen nga vetë shoqëria anonime”.*

Kjo do të thote se ky kuadër rregullator lejon pagesën e anëtarëve të Këshillave Mbikqyrës edhe **pa marrë pjesë në mbledhje** duke sjell për pasojë absurditete te tilla të pagesave kundrejt mungesës së kontributit, dhe shpërblime për punë që nuk është kryer nga përfituesi me impakt të drejtpërdrejte abuzim te fondeve publike.

Sa më sipër argumentojmë:

-Referuar evidencës së paraqitur nga Operatori i Sistemi të Transmetimit sh.a , rezulton se një anëtar i Këshillit Drejtues pa marrë pjesë në asnjë mbledhje ka përfituar për vitin 2013 një pagesë në shumën **104 240 lekë**.

- Dy anëtarët e Këshillit Drejtues në Autoritetin Portual Durrës nga të cilët një anëtar emëruar me shkresën nr 821 datë 12.12.2013 për 15 ditë pune **pa marrë pjesë në asnjë mbledhje** në vitin 2013 ka përfituar shpërblim në vlerën **29 455 lekë dhe një anëtar** për vitin 2014 rezulton një pagesë në shumën **81 000 lekë**.

1.c-Nga auditimi i kryer u konstatuan raste të përfitimit të shpërblimeve për pjesëmarrje cilat variojnë nga 60 000 -162 000 lekë/mbledhje.

Sa më sipër argumentojmë:

1-Në Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a (OST). Nga të dhënat e paraqitura nga vetë shoqëria rezulton që për periudhën Janar-Maj 2015, Këshilli Drejtues i kësaj shoqërie (të gjashtë anëtarët) për dy mbledhje të zhvilluara janë shpërblyer në vlerën 842 500 lekë nga e cila Kryetari i Këshillit Drejtues në vlerën **202 200 lekë** dhe anëtarët secili **nga 134 800 lekë**. Sa më sipër rezulton se anëtarët e Këshillit Drejtues janë shpërblyer me pagë mujore në një periudhë 5 mujore, edhe pse kanë zhvilluar vetëm dy mbledhje dhe *shpërblimi për mbledhje* rezulton respektivisht: Kryetari i Këshillit vlera **101 000 leke/mbledhje** dhe anëtarët në nivelin **67 000 lekë/mbledhje** .

2-Në Autoritetin Portual Durrës sh a. Nga të dhënat e paraqitura nga vetë shoqëria rezulton se për periudhën 5 mujore Janar-Maj 2015 si rezultat i kryerjes se pagesave mujore Kryetari i Këshillit Drejtues, ka përfituar një shpërblim prej rreth **120 000 lekë/mbledhje** dhe anëtarët **90 000 lekë/mbledhje** pra për tre mbledhje të zhvilluara në total Kryetari i Këshillit është shpërblyer me vlerën **355 000 lekë dhe anëtarët secili me 270 000 lekë**.

Krahas sa më sipër rezulton se një anëtar i Këshillit Drejtues, ish- nën Kryetar i Bashkisë Durrës i cili që prej tetë vjetësh (2007-2015) është zgjedhur anëtar Këshilli, konstatohet se vetëm në vitet 2013 dhe 2014 ka marrë pjesë përkatësisht në 6 dhe 10 mbledhje me një vlerë pagë mujore 54 000 lekë dhe është shpërblyer për çdo vit me një vlerë prej **702 000 lekë**, madje për periudhën Janar- Maj 2015 ka marrë pjesë vetëm në **një mbledhje** dhe është shpërblyer në vlerën **162 000 lekë**.

- *Një anëtar i Këshillit Drejtues*, përfaqësues i Bashkisë Durrës, emëruar me shkresën nr. 1783/1 datë 01.04.2015 për një periudhë dy mujore ka marrë pjesë **vetëm në një mbledhje** dhe ka përfituar shpërblim në masën **108 000 lekë**.

- *Një anëtare e Këshillit Drejtues*, përfaqësuese e ish MPPT-së me detyrë Drejtore e Kabinetit vetëm për pjesëmarrje në 4 mbledhje është shpërblyer në total në vlerën **495 818 lekë ose 123 954 lekë për mbledhje**.

- *Zv/Kryetari i Këshillit Drejtues* përfaqësues i ish-METE për pjesëmarrje në tre mbledhje është shpërblyer ne total ne vlerën 348 818 lekë ose **116 272 lekë/mbledhje**.

- *Dy anëtarë të Këshillit Drejtues*, përfaqësues të biznesit privat, janë shpërblyer për pjesëmarrje në gjashtë mbledhje me nga **621 000 lekë secili pra mbi 100 000 lekë për mbledhje**.

(*Trajtuar në faqet 13-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Sa më sipër rekomandoj:

Ministria e Financës në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë Zhvillimit Turizmit Tregëtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) të marrin masa për rishikimin tërësor të kuadrit rregullator referuar veprimtarisë së krijimit, përbërjes dhe shpërblimit të bordeve, këshillave, komisioneve apo organeve të tjera kolegjiale të administratës shtetërore, enteve publike, dhe shoqërive anonime në drejtimet si më poshtë vijon:

a) **Për kufizimin e masës së shpërblimit** që përfitohet nga pjesëmarrja në disa borde/komisione/këshilla apo organe të tjera *rekomandoj:*

Masa e shpërblimit mujor, për funksionarët politikë, nëpunësit civil dhe punonjësit e administratës publike e përfituar si e ardhur nga paga, në ushtrim të funksioneve organike të punonjësit si dhe të ardhurat e realizuara nga pjesëmarrja me kohë të pjesshme në struktura kolegjiale (këshilla, borde, komisione apo organe të tjera) nuk duhet të kalojnë nivelin e pagës mujore të Presidentit të Republikës ose të Kryeministrit, pavarësisht numrit të strukturavë që ata marrin pjesë.

b) **Për kufizimin e numrit të pjesëmarrjes** në strukturave kolegjiale *rekomandoj:*

*Funksionarëve politikë, nëpunësve civilë dhe punonjësve të administratës publike **u ndalohet** pjesëmarrja me të drejtë pagese në më shumë **se një** këshill, bord, komision apo organ tjetër kolegjal në njësitë e qeverisjes qendrore dhe në shoqëritë anonime.*

-Përrjashtohen nga kufizimi i mësipërm anëtarësimi me zgjedhje në Organet e Arsimit të Lartë Publik; i) Këshilli Administrativ ii) Senati Akademik iii) Këshilli i Fakulteteve.

c) Për kufizimin e pjesëmarrjes të kategorisë së punonjësve “Funksionarë kabinetit” në përbërje të strukturave kolegjinale.

Nga auditimi i ushtruar u konstatua se nga ana e titullarëve të Ministrive janë emëruar pjesëmarrës në borde, komisione, këshilla apo organe të tjera kolegjinale Drejtorë Kabinetit dhe Këshilltarë Ministrash të cilët referuar Ligjit nr 152/2013 “Për nëpunësin civil” neni 2 pika gj “Fusha e veprimit” dhe neni 4 “Përkufizime” pika c nuk përfshihen në kategorinë e punonjësve të nëpunësve civil por “Funksionarë kabinetit” dhe konkretisht (citimi i nenit 4 të ligjit): “Funksionar i kabinetit” është nëpunësi pjesë e kabinetit të Presidentit Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendës Kryeministrit, apo pjesë e kabinetit të një titullari të një institucioni të pavarur apo një funksionari të emëruar nga Kuvendi ose Presidenti nëse parashikohet nga ligji që kryen detyra të drejtorit të kabinetit këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit apo sekretarit personal të titullarit të kabinetit”.

Pjesëmarrja në struktura kolegjinale e kësaj kategorie punonjësish e cila nuk gëzon statusin e nëpunësit civil sjell për pasojë ndërrimin e tyre sa herë që ndërrohen stafet e kabinetit të Titullarëve. Nëse do të referoheshim kuadrin rregullator rezulton se strukturat kolegjinale dhe ne veçanti, Këshillat Mbikëqyrëse/Drejtuëse janë organe drejtuese të shoqërive me funksione vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse e në këtë aspekt duhet të funksionojnë si organe thellësisht teknike.

Sa më sipër rekomandoj :

Në kuadrin e ri rregullator të vendoset kufizimi sipas të cilit: Përrjashtohen nga pjesëmarrja në këshilla, borde, komisione apo organe të tjera kolegjinale punonjësit që në ligjin nr 152/2013 “Për nëpunësin civil” përfshihen në kategorinë “Funksionarë kabinetit”.

d) Për kufizimin e pjesëmarrjes së anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në organe të tjera kolegjinale.

- Këshilli i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë përfaqëson një bord specifik me detyra të rëndësishme dhe komplekse të lidhura me drejtimin dhe monitorimin e një tregu të rëndësishëm si ai monetar, me reflektime të qarta dhe të mprehta në gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë, dhe në këtë aspekt **angazhimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues në organe të tjera kolegjinale** sjell për pasojë dhe **risqet potenciale** gjatë procesit të vendimmarrjes.

*Sa më sipër rekomandoj: Në kuadrin e ri rregullator të vendoset kufizimi sipas të cilit: Anëtarëve të Këshillit Drejtues të Bankës së Shqipërisë **u ndalohet** pjesëmarrja në borde/komisione/këshilla apo organe të tjera kolegjinale të administratës shtetërore apo enteve publike, përveç strukturave të fushës akademike dhe shkencore.*

e) Në funksion të eliminimit të shpërblimit të anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës pa marrë pjesë në mbledhje, **rekomandoj** që në kuadrin e ri rregullator të parashikohet një klauzolë në të cilën të përcaktohet: *Shpenzimet për kryerjen e pagesës së punonjësve në përbërje të Këshillave Mbikëqyrëse të kryhen bazuar në dokumentin vërtetues të pjesëmarrjes në mbledhje”.*

2-Mbi hartimin e një kuadri të ri rregullator të Këshillave Mbikëqyrës të shoqërive anonime.

Nga auditimi u konstatua mospërputhje në drejtim të përcaktimeve të Ligjit nr. 10 264, datë 8.4.2010 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” dhe VKM nr. 642, datë 11.10.2005 i ndryshuar e Udhëzimit nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, dhe konkretisht:

Në Ligjin nr. 10 264, datë 8.4.2010 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar në nenin 8, përcaktohet që:

“Anëtarët e Këshillave Mbikëqyrëse të shoqërive aksionere shtetërore i propozohen Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (sot MZHETTS) si më poshtë:

- a) 1/3 e anëtarëve propozohet nga Ministri i Financave;
- b) 1/3 e anëtarëve caktohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- c) 1/3 e numrit të anëtarëve propozohet nga ministria e linjës administrative apo nga organi i qeverisjes vendore, që përfaqëson shtetin për shoqërinë shtetërore përkatëse.

Sa më sipër Ministria e Financës ka të drejtën e propozimit të 1/3 të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërive anonime.

-Konstatohet se në VKM nr 642 datë 11.10.2005 ndryshuar me VKM nr. 677 datë 03.10.2007 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime shtetërore “ pika 2, përcaktohet se “Anëtarët e Këshillave Mbikëqyrëse propozohen :

-2/3 e numrit të kandidaturave propozohen nga ministrinë e linjës administrative ose organet e qeverisjes vendore

-1/3 propozohet nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikes , sot MZHETTS.

Sa trajtuar më lart **rezulton mospërputhje** midis përcaktimit të Ligjit nr 10264 datë 08.04.2010 me ndryshime dhe VKM 642 datë 11.10.2005 me ndryshime, referuar propozimeve të kandidaturave duke reduktuar nga 2/3 në 1/3 kandidaturat qe propozohen nga Ministria e linjës administrative apo organet e qeverisjes vendore që përfaqësojnë shtetin në shoqërinë përkatëse dhe shtuar propozimin e 1/3 së kandidaturave që do të propozohen nga Ministria e Financës.

Nga ana tjetër konstatohet se ndryshimi i nenit 8 i ligjit, duhej të reflektohej edhe në aktet rregullative nënligjore pra në VKM nr. 642, datë 11.10.2005 i ndryshuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë nr. 318 datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”.

Ndryshimi me ligj dhe sanksionimi që 1/3 e kandidaturave do të propozohen nga Ministria e Financave sikurse u konstatua nga auditimi nuk ka rezultuar i efektshëm pasi ishin propozuar individë të cilët ose nuk ishin punonjës efektivë të Ministrinë e Financave, apo edhe në ato raste që ishin punonjës të Ministrisë së Financave ishin emëruar punonjës të cilët nuk mund të ofronin ekspertizën e duhur. Nga ana tjetër propozimi i 1/3 së kandidaturave nga Ministria e Financave nuk përbën vlerë të shtuar në drejtim të kontributit apo të ekspertizës teknike që mund të ofrohet nga punonjësit e kësaj ministrie.

Sa më sipër rekomandoj:

Nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes të ndërrmeret iniciativa për :

a) Ndryshimin e Ligjit nr. 10 264, datë 8.4.2010 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar në nenin 8, duke kërkuar **shfuqizimin** e pikës nr 1.a. te nenit 8, në të cilën përcaktohet që “**1/3 e anëtarëve propozohet nga Ministri i Financave**” dhe neni 8 **të riformulohet**:

“Anëtarët e Këshillave Mbikëqyrëse të shoqërive aksionare shtetërore i propozohen Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (sot MZHETTS) si më poshtë:

-1/3 e anëtarëve caktohet nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes (ish METE) ;

-2/3 e numrit të anëtarëve propozohet nga ministria e linjës administrative apo nga organi i qeverisjes vendore, që përfaqëson shtetin për shoqërinë shtetërore përkatëse.

b) rishikimin dhe ripunimin thelbësor të kuadrit rregullator me synim hartimin një **Vendimi të ri të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimi të ri** duke reflektuar të gjitha problematikat e këtyrë 15 viteve pasi si VKM nr 642 datë 11.10.2005 i ndryshuar me VKM nr 677 datë 03.10.2007 “**Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore dhe ne Udhëzimin e Ministrit nr 318 datë 08.04.2009** “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore” datojnë që para daljes së Ligjit nr 10264 datë 08.04.2010.

Menjëherë

3. Në drejtim të përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes së kandidaturave për anëtar të Këshillave Mbikëqyrës në shoqëritë anonime.

Në Udhëzimin Nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, dalë në zbatim të VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, është përcaktuar se:

Pika I.3 Kriteret dhe përbërja e Këshillit Mbikëqyrës:

Kandidati për anëtar në Këshillin Mbikëqyrës duhet të plotësojë, kriteret si më poshtë:

a) Të jetë punonjës i institucioneve shtetërore qendrore, që kanë administrim të drejtpërdrejtë me sektorin ku bën pjesë shoqëria, kur legjislacioni nuk pengon pjesëmarrjen e tyre në funksione të tjera.

b) Mund të jetë specialist i institucioneve kërkimore shkencore,

c) Pedagog i universiteteve Shtetërore, me vjetërsi në punë jo më pak se 5 vjet, si dhe

d) Persona që gëzojnë autoritet profesional në fusha të caktuara.

Si udhëzimi Nr. 318, datë 08.04.2009 dhe VKM nr. 642, datë 11.10.2005 me ndryshime referuar kriterëve të mësipërme janë shumë të përgjithshme duke lënë shteg për propozimin e kandidaturave mbi baza subjektive, dhe që nuk disponojnë dhe ofrojnë ekspertizën teknike të fushës.

Nga auditimi i kryer mbi plotësimin e kriterëve të përcaktuara si më sipër rezultoi se në një numër të konsiderueshëm shoqëriish anonime nga Titullarët e Ministrive (MZHETTS, Ministria e Financës dhe Ministria e Transporteve dhe Industrisë) ishin propozuar dhe emëruar punonjës detyrat e tyre

funkcionale nuk kishin të bënin me veprimtarinë dhe sektorin në të cilën bënte pjesë shoqëria duke sjellë për pasojë mungesën e ekspertizës teknike dhe për më tepër *shpenzimin e fondeve për shpërblimin e tyre për një punë/shërbim të cilën ata nuk mund ta ofrojnë* duke shkaktuar në këtë mënyrë abuzime me fonde publike dhe ulje të performancës funksionale dhe vendimmarrëse të këtyre strukturave.

Në opinion të përgjithshëm mund të thuhet se janë bërë emërimet të tilla ku disa individë sigurojnë pagesa mujore të konsiderueshme si shpërblime por që profesionalisht nuk japin dhe teknikisht nuk mund të japin ekspertizën e nevojshme pra marrin shpërblime për një punë që nuk e ofrojnë me impakt abuzivitetin e fondeve publike.

Më poshtë rendisim disa nga rastet e evidentuara nga auditimi ku në mënyrë arbitrare nuk janë zbatuar kriteret e përcaktuara në kuadrin rregullator dhe konkretisht:

Nga Ministri i MZHETTS janë emëruar individë që nuk janë pjesë e stafit të institucionit, eksperiencat profesionale të të cilëve nuk kanë lidhje me aktivitetin e sh.a-ve dhe ndërkohë që emërimi i tyre është si anëtar i Këshillave Mbikqyrës nën cilësimin “përfaqësues i MZHETTS”, konkretisht:

1-Drejtori i Drejtorisë Arsimore Sarandë është emëruar si anëtar i Këshillit Mbikqyrës në sh.a “Porti Detar”, Sarandë. Nga shqyrtimi i CV të këtij përfaqësuesi rezulton të jetë i diplomuar në Degën e Gjuhë Letërsisë, eksperiencat në punë e këtij punonjësi *nuk ka lidhje me aktivitetin e shoqërisë* dhe emërimi i këtij individ është në kundërshtim me kriteret ligjore.

2-Një individ me statusin pensionist diplomuar për veterinari është emëruar në funksionin e Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës të sh.a “Trajtimi i Studentëve” Vlorë si përfaqësues i MZHETTS.

3-Një gazetar punonjës i TVSH, diplomuar në Institutin e Lartë të Arteve, Dega “Regjistrë” është emëruar si anëtar i Këshillit Mbikqyrës në sh.a “Porti Detar”, Vlorë dhe si anëtar i Këshillit Mbikqyrës në sh.a “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare”, Tiranë.

4-Një punonjëse e Bashkisë Durrës në pozicionin Shefe e Shërbimit Social është emëruar si anëtare e Këshillit Mbikqyrës të sh.a.”NPV Ushtarake” Tiranë. Nga shqyrtimi i CV rezulton se ka mbaruar studimet në shkencat sociale dega psikologji, dhe eksperiencat e punësimit i ka kryesisht në OJF-te për çështje të drejtave njeriut, dhunën në familje dhe barazinë gjinore.

5-Një përfaqësues i biznesit privat në fushën e aktivitetit detar është emëruar anëtar i Këshillit Mbikqyrës i sh.a “Albbakër” Tiranë në cilësimin e përfaqësuesit të MZHETTS.

6-Drejtorja Departamentit të Administratës Publike është emëruar si anëtare e Këshillit Mbikqyrës në sh.a “Aeroporti Nënë Tereza” Tiranë

7-Drejtorja Shërbimeve Mbështetëse në Këshillin e Ministrave është emëruar si anëtare e Këshillit Mbikqyrës të sh.a.”Porti Detar”, Shëngjin, dhe në sh.a “Alba Film Studio” Tiranë.

8-Drejtori i Drejtorisë së Pastrimit të Parave është emëruar si anëtar i Këshillit Mbikqyrës të sh.a. “Trajtimi i Studentëve Nr.3”, Tiranë.

9-Drejtorja e Departamentit të Programit Zhvillimit, Financimeve Ndihmës së Huaj në Kryeministri është emëruar, si anëtare e Këshillit Mbikqyrës të sh.a. “Porti Detar”, Shëngjin.

10-Një individ me statusin pensioniste është emëruar si anëtare e Këshillit Mbikqyrës tek sh.a “Hekurudha Shqiptare” Durrës.

Nga auditimi i kryer u konstatua se në disa raste Ministri i Financave, ka propozuar kandidatura të cilat janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 318, datë 08.04.2009 dhe që bazuar në këto propozime nga Ministri i MZHETTS, janë emëruar më pas si anëtarë në Këshillat Mbikqyrës.

Konstatohet se kandidatët e propozuar për anëtarë në Këshilla Mbikqyrës, nuk kanë qenë pjesë e stafit të institucionit të Ministrisë së Financave por ndërkohë janë propozuar nën cilësimin “përfaqësues të Ministrisë së Financave” dhe konkretisht:

1-Një avokat, është propozuar dhe më pas emëruar si anëtarë i Këshillit Mbikqyrës në sh.a “Trajtimi i Studentëve Nr. 3” Tiranë.

2-Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme është emëruar anëtarë i Këshillit Mbikqyrës në sh.a “Anta” Tiranë.

3-Një Këshilltare në Këshillin e Ministrave, propozuar dhe më pas miratuar si anëtare e Këshillit Mbikqyrës në sh.a “Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor” Tiranë.

4-Një specialist në KESH sh.a është propozuar dhe emëruar si anëtar Këshillit Mbikqyrës në sh.a “Prodhim Mobilje” Tiranë.

5-Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse në Këshillin e Ministrave është propozuar dhe emëruar si anëtare e Këshillit Mbikqyrës në Sh.a “Alba film studio “Tiranë”.

Nga auditimi rezultoi se nga Ministri i Financave janë propozuar, kandidatë për anëtar në Këshillin Mbikqyrës punonjës të Ministrisë së Financave por në referencë të ekspertizës teknike të fushës që mbulojnë në sh.a-të respektive nuk përkojnë me sektorin që ata kanë në administrim në ushtrim të detyrave të tyre funksionale konkretisht:

1-“Këshilltari për mediat” në Kabinetin e Ministrisë e Financave, është propozuar dhe më pas emëruar si anëtar Këshillit Mbikqyrës në sh.a “Hekurudha Shqiptare” Durrës, dhe në sh.a “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”.

2-Përgjegjësja e Sektorit të Huamarrjes në Drejtorinë e Menaxhimit të Borxhit Publik, është propozuar dhe emëruar si anëtare e Këshillit Mbikqyrës në sh.a “Trajtimi i Studentëve” Shkodër dhe në sh.a “Albkrom” Tiranë.

3-Drejtorja e Drejtorisë së Borxhit të Jashtëm është propozuar dhe emëruar anëtare e Këshillit Mbikqyrës në sh.a “Agjencia Detare Taulantia”, Durrës.

(Sa trajtuar në faqet 13-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Sa më sipër rekomandoj:

Marrë shkas nga konstatimi se në VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillave Mbikqyrëse janë shumë të përgjithshme, jo specifike duke lënë shteg për emërimin e individëve të cilët nuk kanë lidhje me aktivitetin e shoqërisë anonime nga MZHETTS të reflektohen në kuadrin e ri rregullator kriteret që duhet të përmbushin kandidaturat për të marrë pjesë në Këshilla Mbikëqyrëse.

Rishikimi dhe ndryshimi i kriterëve të përzgjedhjes së emërimit të anëtarëve të Këshillave Mbikqyrëse në sh.a të synojë në përcaktimin e kriterëve specifike në drejtim të kualifikimeve, përvojës, eksperiencës dhe ekspertizës teknike që duhet të disponojë kandidati dhe që kanë lidhje organike me aktivitetin që zhvillon shoqëria anonime.

Krahas sa më sipër si kriter parësor duhet që kandidati të jetë personalitet i fushës, të emërohet nga strukturat shtetërore që kanë në administrim shoqërinë anonime shtetërore.

-Si kriter i veçantë duhet të jetë dhe orientimi i kandidaturave si profesorë të universiteteve publike që janë profesionistë të fushës, gazetarë ekonomikë etj, pra individë të spikatur në fushën dhe aktivitetin që mbulon shoqëria.

Menjëherë

4-Mbi përcaktimin e strukturës e cila ka kompetence propozimin e kandidaturave.

-Nga auditimi u konstatua se në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikqyrës të shoqërive anonime shtetërore” në Udhëzimin e METE Nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, nuk është përcaktuar se, kush është struktura përgjegjëse në Ministri që kryen nominimin dhe përzgjedhjen e kandidaturave si dhe struktura që duhet të mbajë bazën e të dhënave të angazhimit të punonjësve të Ministrisë apo dhe të institucioneve vartëse të angazhuar në struktura kolegjiale. Në udhëzimin nr.318, datë 08.04.2009 vetëm për përfaqësuesit e MZHETTS, është përcaktuar se kandidaturat paraqiten nga drejtues të dikasterit. Për ministrinë e tjera të linjës nuk ka një procedurë të përcaktuar, pra rezulton *boshllëk procedural se si dhe cila* strukture në dikaster i propozon përfaqësuesit në Këshilla Drejtues.

Sa më sipër rekomandoj: Në VKM dhe Udhëzimin e ri që do të hartohet të parashikohet ngritja e një Komisioni pranë Ministrisë të MZHETS i përbërë nga personalitete dhe që të jetë përgjegjës për përzgjedhjen dhe nominimin e kandidaturave. Procedurat e përzgjedhjes duhet të kryhen nëpërmjet një procesi konkurimi i cili duhet të jetë i hapur, transparent bazuar në dosjet dhe dokumente dëshmuuese të aftësive dhe ekspertizës që mund të ofrojnë e të tjera kritere. Po kështu duhet të parashikohet edhe struktura përgjegjëse në Ministrinë e linjës për mbajtjen e bazës së të dhënave të angazhimit të punonjësve të ministrisë apo dhe të institucioneve të linjës së varësisë.

Menjëherë

5-Mbi përjashtimin e individëve me statusin pensionist në përbërjen e strukturave kolegjiale.

-Nga auditimi u konstatua që individë të cilët janë me statusin “pensionist” janë emëruar anëtarë të bordeve, komisioneve, këshillave dhe që rezultojnë me një moshë të konsiderueshme (70-80 vjeç), gjë e cila biologjikisht e bën të pamundur rolin kontributiv të individit, pjesëmarrjen formale të tyre me pasojë kryerjen e pagesave jo eficiente.

(Trajtuar në faqet 19-27 të Raportit Perfundimtar të Auditimit)

Sa më sipër rekomandoj që në kuadrin rregullator si për bordet, komisionet, këshillat e institucioneve të qeverisjes qendrore dhe shoqëritë anonime të vendoset kufizimi që për individët të cilët janë me statusin “pensionist” të mos emërohen anëtarë të bordeve, komisioneve, këshillave apo organeve të tjera kolegjiale mbikëqyrëse . Raste përjashtimore mund të jene vetëm fushat e artit dhe të kulturës dhe personalitetet ende aktivë të shkencës.

6-Mbi përmirësimin e kuadrit rregullator për sh.a Ujësjellës Kanalizime .

Para transferimit të ish-ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizime në pushtetin vendor, veprimtaria e Këshillave Mbikqyrëse rregullohej bazuar në VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për funksionimin e Këshillave Mbikqyrës”, ndryshuar me VKM nr.677, datë 3.10.2007 dhe VKM nr. 215, datë 28.3.2012.

Pas daljes së VKM nr. 660, datë 12.09.2007 “Për transferimin e aksioneve të Shoqërive të Ujësjellësve dhe Kanalizimeve Njësive të Qeverisjes Vendore” dhe një sërë vendimesh të tjera të mëvonshme u bë transferimi i aksioneve dhe pronave nga Ministria e Ekonomisë në pushtetin vendor duke ndryshuar edhe statusin juridik nga ish-ndërmarrje shtetërore në shoqëri anonime shtetërore duke bërë edhe regjistrimin në QKR.

Në zbatim të VKM nr. 660, datë 12.09.2007 “Për transferimin e aksioneve të Shoqërive të Ujësjetësve dhe Kanalizimeve Njësive të Qeverisjes Vendore”, me propozim të Ministrisë Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjetës-kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore, ka dale udhëzimi METE nr. 965, datë 11.12.2007 “Për zbatimin e VKM “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjetës-kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore”, udhëzim i cili përcakton mënyrën e transferimit të aksioneve dhe organizimi i mbledhjeve të para të asamblesë aksionarëve, zgjedhja e anëtarëve të Këshillave Mbikqyrëse , mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës, etj.

Në VKM nr. 271, datë 09.05.1998 “Për Miratimin e statutit tip të shoqërive anonime shtetërore, me ndryshimin e bërë me VKM nr. 678, datë 3.10.2007, është shtuar pika 2/1 ku përcaktohet se për shoqëritë anonime të ujësjetës-kanalizimeve, statuti tip do të jetë sipas tekstit, që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Po në pikën 2 të, paragrafi dytë të këtij VKM përcaktohet se: Për shoqëritë anonime që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në sektorë me rëndësi të veçante të ekonomisë, Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ka kompetencë ta ndryshojë këtë statut në përputhje me ligjin për shoqërinë tregtare. Sektorët me rëndësi të veçante janë sektorët e përcaktuar në ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lire, të veprimtarive të pavarura private dhe privatizimit", i ndryshuar me ligjin nr. 8306, datë 14.03.1998 dhe me ligjin nr. 10 166, datë 15.10.2009 neni 4, i cili parashikon se: Sektorë me rëndësi të veçantë të ekonomisë janë: industria e energjetikës dhe e mineraleve, e naftës dhe gazit, postat telekomunikacionet, pyjet dhe ujërat, rrugët automobilistike e hekurudhore, portet detare, aeroportet, transporti ajror e hekurudhor.

Nuk do të konsiderohen pjesë e sektorëve me rëndësi të veçantë ndërmarrjet, shoqëritë tregtare ose pjesë të tyre, të cilat kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike dhe kanë rezultat financiar me humbje për mbi 3 vjet rresht. Këto raste përcaktohen me vendim të Këshillit Ministrave.

Pra në asnjë nga aktet e mësipërme nuk përcaktohet qartë:

- a. Ku klasifikohen Ujësjetës sh.a; në shoqëri strategjike, jo strategjike, apo jostrategjike vendore.
- b. Si do të bëhet shpërblymi (pagesa) e Këshillave Mbikqyrës; mbi bazën e përqindjes së pagës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë Turizmit dhe Sipërmarrjes, apo meqenëse aksionet janë transferuar në pushtetin vendor do të paguhet në përqindje mbi bazën e pagës së Sekretarit të Përgjithshëm të Prefekturës.
- c. Si do të bëhet pagesa dhe masa e shpërblymit të Sekretarit të Këshillit Mbikqyrës.

Krahas sa më sipër KLSH në vijimësi gjatë veprimtarisë audituese institucionale është fokusuar edhe trajtimin e gjendjes financiare të sh. a Ujësjetës Kanalizimeve. Në Raportin paraqitur në Kuvend “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013” i ka adresuar Kuvendit një sërë problematikash të konstatuara në Sektorin e Ujësjetës Kanalizimeve referuar shlyerjes së detyrimeve në marrëveshjet kontraktuale të nënhuave reflektim dhe i performancës së dobët të këshillave mbikqyrës dhe konkretisht:

Sektorin e Ujësjetës Kanalizimeve, i cili zë një peshe të konsiderueshme të portofolit të nënhuave, paraqitet me mjaft problematika në shlyerjen e detyrimeve, të cilat kanë si shkak **paaftësinë financiare e ndërmarrjeve të UK**. Me përjashtim të UK Korçë të gjitha shoqëritë e tjera të UK ose nuk paguajnë fare, ose shlyejnë pjesërisht detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuazimit të fondeve me Ministrinë e Financave. Nga auditimi ka rezultuar se në fund të vitit 2013 për ndërmarrjet e ujësjetësve rezultoni detyrimet të papaguara për projektet, në shumën prej 2,037,169 mijë lekë ose në rreth 14 milionë euro.

Sa më sipër rekomandoj:

*Në funksion të unifikimit të mënyrës së pagesës së anëtarëve dhe sekretarëve të Këshillit Mbikqyrës të Ujësjetllës-Kanalizime sh.a, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrinë e Shtetit për Çështjet Vendore dhe Ministrinë e Financave, që të ndërmerin nismën ligjore dhe të paraqesin në Këshillin e Ministrave, **projekt-vendim mbi mënyrën dhe masën e pagesës së anëtarëve dhe sekretarëve të Këshillit Mbikqyrës të Ujësjetllës-Kanalizime sh.a**, kryesisht në rregullimin e problemeve të mëposhtme:*

-Shoqëritë e Ujësjetllësve sh.a, aksionet e të cilëve janë transferuar në pushtetin vendor të mos klasifikohen si Shoqëri Strategjike, por si Shoqëri jo strategjike vendore, pasi nuk mund të konsiderohet shoqëri strategjike një Ujësjetllës me 10 punonjës.

-Pagesa e Këshillave Mbikqyrës të mos kushtëzohet nga paga e Sekretarit të Përgjithshëm të Prefekturës, por nga tregues të tjerë, si numri i punonjësve, xhiroja apo volumi i shitjeve të ujit, etj.

-Pagesa e sekretarit të Këshillit Mbikqyrës të vendoset për pjesëmarrjen në çdo mbledhje të zhvilluar dhe jo pagë fikse mujore dhe njëkohësisht të jetë punonjës i Shoqërisë.

-Në këtë kuadër të bëhet edhe rregullimi i sistemit të pagave të Shoqërive të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a, duke vendosur kufij maksimalë për pagat e punonjësve dhe veçanërisht unifikimin e pagave të administratës dhe drejtorit të shoqërisë në vendosjen raporteve të drejta me pagat e punonjësve. Kjo pasi u konstatuan raste të caktimit të pagës së drejtorit të shoqërisë nga ana e Këshillit Mbikqyrës në nivele mjaft të larta; përmendim rastin e Ujësjetllësit sh.a Puke-Fshat ku paga e Drejtorit ishte caktuar 90 000 lekë/muaj, ndërkohë që shoqëria kishte gjithsej 10 punonjës.

-Të rishikohet numri i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, me synim reduktimin e numrit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, pasi si shoqëritë me 10 punonjës dhe ato me mbi 600 punonjës kanë të njëjtin numër prej 6 anëtarësh.

Menjëherë

B-MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: U konstatua se Ministri i MZHETTS, në 21 raste ka emëruar anëtarë të Këshillave Mbikqyrës të shoqërive anonime, **në kundërshtim me kriteret e përcaktuara** në Udhëzimin e MZHETTS nr. 318, datë 08.04.2009, pika 3 në të cilin përcaktohet që:

“Kandidati për anëtar në Këshillin mbikqyrës duhet të plotësojë, kriteret si më poshtë:

-Të jetë punonjës i institucioneve shtetërore qendrore, që kanë administrim të drejtpërdrejtë me sektorin ku bën pjesë shoqëria, kur legjislacioni nuk pengon pjesëmarrjen e tyre në funksione të tjera, apo që të jetë specialist i institucioneve kërkimore shkencore, pedagog i universiteteve Shtetërore, me vjetërsi në punë jo më pak se 5 vjet, si dhe persona që gëzojnë autoritet profesional në fusha të caktuara” dhe konkretisht:

U konstatua se nga 21 rastet e evidentuara nga KLSH si emërimet në kundërshtim me kuadrin rregullator sipas shkresës nr. 6506, datë 21.08.2015 të MZHETTS drejtuar KLSH-së, nga ana e Ministrit, rezultoi se janë nxjerrë Urdhrat e lirimit nga Këshilli Mbikqyrës për 11 anëtarë në përbërje të **këshillave mbikqyrës të shoqërive anonime si vijon: Në sh.a. “Albbakër Tiranë; “NPV Ushtarake” Tiranë (2 anëtarë); sh.a. “Porti Detar” Sarandë (dy anëtarë); sh.a “Trajtimi i studenteve” Vlorë; sh.a “Tipografia Ushtarake” Tiranë; sh.a “Rezidenca Universitare nr. 1” Tiranë; sh.a “Tregu i shitjes me shumicë fruta perime” Shkodër; sh.a “Trajtimi i studentëve nr. 3” Tiranë; dhe sh.a “Hekurudha Shqiptare” Durrës.**

Nga 21 raste të evidentuara nga KLSH si emërime në kundërshtim me kuadrin rregullator, nga ana e Ministrisë të MZHETTS nuk janë nxjerrë Urdhra lirimi për 10 raste të tjera.

(Trajtuar hollësisht në faqet 13-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Sa më sipër rekomandoj :

Nga Ministri i MZHETTS të shqyrtohet dhe analizohet përbërja e Këshillave Mbikqyrës dhe të nxirren urdhrat e lirimit si anëtar të Këshillave Mbikqyrës për të gjitha emërimet e evidentuara në kundërshtim me kërkesat e kuadrit rregullator në shoqëritë anonime si vijon:

Në sh.a “Porti Detar”, Vlorë; sh.a “Korporata Elektroenergjitik Shqiptare; sh.a “Aeroporti Nënë Tereza”, Tiranë (2 raste); sh.a “Albbakër” Tiranë; sh.a “Porti Detar” Shëngjin (2 raste); sh.a “Alba Film Studio” Tiranë ; sh.a. Trajtimi i Studentëve nr. 2 Tiranë; dhe sh.a “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” Tiranë.

Menjëherë

2-Gjetje nga Auditimi: U konstatua se nga Ministri i Financave dhe Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës në 12 raste janë propozuar Ministrinë të MZHETTS, si kandidatura për anëtarë në këshilla mbikqyrës, individë të cilët nuk kanë qenë pjesë e stafit të Ministrive.

(Sa trajtuar hollësisht në faqet 23-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Sa më sipër rekomandoj:

*Nga ana e Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik Turizimit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes t’i kërkohet Ministrinë të Financave dhe Ministrinë të Transportit dhe Infrastrukturës, analizimi dhe shqyrtimi i përfaqësuesve të Ministrive si anëtar të Këshillave Mbikqyrës të shoqërive anonime të linjës administrative. Më pas të procedohet me propozimin e **kandidaturave të reja** të cilët domosdoshmërisht duhet të jenë pjesë e stafit të Ministrive respektive dhe të plotësojnë kërkesat e kuadrit rregullator me objektiv mundësimin e ofrimit të ekspertizës teknike profesionale të fushës.*

Në veçanti të shqyrtohet përbërja e anëtarëve të Këshillave Mbikqyrës të evidentuar nga KLSH në kundërshtim me kërkesat e kuadrit rregullator, në shoqëritë anonime si vijon:

Në sh.a “Trajtimi i Studentëve nr. 3” Tiranë; sh.a “Anta” Tiranë, sh.a “Tregtimi i Librit Artistik dhe Shkencor”; Tiranë; “ASD” Tiranë; sh.a “Prodhim Mobilje” Tiranë; sh.a “Alba film studio “Tiranë”; “Bordi Artistik të Teatrit Kombëtar”; sh.a “Hekurudha Shqiptare” Durrës, sh.a “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”; sh.a “Trajtimi i Studentëve” Shkodër e sh.a “Albkrom” Tiranë; sh.a “Agjencia Detare Taulantia”, sh.a “Regjistri Detar Durrës”; sh.a “Porti Detar Shëngjin”.

Menjëherë

3. Për Ujësjetllës Kanalizime sh.a

Gjetje nga Auditimi:

a. Bazuar në evidencat e paraqitura në KLSH rezulton se nga 56 Ujësjetllës sh.a në shkallë vendi 50 prej tyre pagesat e Këshillit Mbikqyrës i kanë kryer bazuar në pagën e Sekretarit të Përgjithshëm të Prefekturës në masën 90,000 lekë ose nga 18,000-27,000 lekë /muaj, duke u pajisur me vërtetim nga Prefekturat përkatëse.

Këto pagesa janë bazuar në Udhëzimin e Ministrisë Ekonomisë dhe Tregtisë nr. 29, datë 13.01.2006 ”Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikqyrës në shoqëritë anonime” udhëzim i cili përcakton se: Shoqëritë që kanë kaluar në pronësi të pushtetit vendor dhe të tjera që me VKM

të veçantë, do të kalojnë gradualisht, do të shpërblehen 30% për kryetarin dhe 20% për anëtarët, me pagën e Sekretarit të Përgjithshëm të Prefekturës. Por ky udhëzim është shfuqizuar me Udhëzimin e METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore, dhe në fuqi ka qenë kriteri i përcaktuar me VKM 642 datë 11.10.2005 që referuese duhej të ishte paga e Sekretarit të Përgjithshëm të MZHETTS-it. Nga auditimi rezultoi se pavarësisht shfuqizimit të Udhëzimit nr. 29, datë 13.01.2006 në 50 Ujësje sh.a nga 56 gjithsej, pagesa e anëtarëve të Këshillave Mbikqyrës ka vazhduar mbi bazën e pagës Sekretarit të Përgjithshëm të Prefekturës.

b.Nga 56 Ujësje sh.a, në shkallë vendi 44 Ujësje sh.a i kanë paguar **sekretarët** e Këshillit Mbikqyrës në masën 5,000 lekë/muaj, ndërsa 9 Ujësje sh.a i kanë paguar më tepër respektivisht: Mirditë 46,000 lekë/muaj, Ura Vajgurore 18,000 lekë/muaj, Ujësje sh.a Elbasan-Qytet 15,000 lekë/muaj, Patos 22.320 lekë/muaj duke e paguar njësoj me anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, në Ujësjesat Korçë Fshat, Tepelenë, Pogradec dhe Sarandë nga 12,000 lekë/muaj dhe Elbasan Fshat 6,000/muaj.

Sa më sipër rekomandoj:

Deri në daljen e akteve përkatëse, për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe sekretarit të Këshillit Mbikqyrës nga ana e Ujësjes Kanalizime sh.a të zbatohen plotësisht dispozitat nënligjore, dhe konkretisht:

VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikqyrës të shoqërive anonime shtetërore” pika 6, përcakton se: Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës përfitojnë shpërblim për pjesëmarrje në Këshillat Mbikqyrës si më poshtë vijon;

a) Në shoqëritë anonime shtetërore jostrategjike vendore, për kryetarin, në masën 30 përqind të pagës mujore të sekretarit të përgjithshëm të prefekturës dhe për anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikqyrës, 20 përqind të kësaj page.

b)Udhëzimi i METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”, pika 5 ku përcaktohet se: Me propozim të Ministrit të METE-s (të autorizuarit e tij), Këshilli Mbikqyrës, në mbledhjen e tij të parë zgjedh me shumicë votash kryetarin dhe nënkryetarin. Këshilli Mbikqyrës mund të caktojë gjithashtu edhe një sekretar, me një shpërblim mujor deri në 15 000 lekë për shoqëritë strategjike dhe deri 5000 lekë për ato jostrategjike. Sekretari i Këshillit Mbikqyrës do të jetë përfaqësues i shoqërisë apo përfaqësues i METE-s.

c. Në se për personat e cituar në pasqyrën bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit janë kryer pagesa edhe pas datës 30.06.2015, të kryejnë ndalesat përkatëse edhe për periudhën në vijim.

Menjëherë

4-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në Ujësje Divjakë sh.a rezultoi se një anëtarë e Këshillit Mbikqyrës nuk ka marre pjesë në asnjë nga 8 mbledhjet të Këshillit Mbikqyrës, respektivisht 3 për vitin 2013, 3 për vitin 2014 dhe 2 mbledhje për vitin 2015, ndërkohë nga Këshilli Mbikqyrës nuk i është bërë prezent Ministrit të Ekonomisë,Tregtisë dhe Energjetikës, me qëllim që ta zëvendësonin, duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e METE, nr.318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”, pikën 9 ku përcaktohet se: Në se një anëtar i Këshillit Mbikqyrës nuk merë pjesë në 3 mbledhje radhazi, atëherë Ministri i Ekonomisë,Tregtisë dhe Energjetikës merr vendimin për lirimin e tij nga detyra.

(Sa trajtuar në faqen 162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Sa më sipër rekomandoj:

Këshilli Mbikqyrës i Ujësjetllësit sh.a Divjakë, të shqyrtojë e analizojë pjesëmarrjen në anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës për periudhën 2013-Maj 2015 dhe të propozojë Ministrin të Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes largimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të cilët rezultojnë që nuk kanë marrë pjesë në 3 mbledhje radhazi.

Menjëherë

5-Gjetje nga auditimi: Nga ana e Këshillit Mbikqyrës i Ujësjetllësit sh.a Divjakë që nga krijimi i tij, sipas Urdhrit të Ministrin të Energjetikës nr. 579, datë 18.06.2013, për periudhën dy-vjeçare që funksionon ky këshill, për veprimtarinë ekonomiko-financiare të shoqërisë asnjëherë nuk i është raportuar Ministrin të MZHETTS, në cilësinë e përfaqësuesit të pronës shtetërore, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për funksionimin e Këshillave Mbikëqyrës”, ndryshuar me VKM nr. 677, datë 3.10.2007 dhe VKM nr. 215, datë 28.3.2012, pikën 8 ku përcaktohet se: Këshilli Mbikqyrës mblidhet jo më pak se katër herë në vit dhe i raporton, për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, ministrin të linjës dhe Ministrin të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës, me cilësinë e përfaqësuesit të pronës shtetërore, jo më pak se 4 herë në vit.

(Sa trajtuar në faqet 161-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Sa më sipër rekomandoj:

Këshilli Mbikëqyrës i Ujësjetllësit sh.a Divjakë dhe Drejtoria e Shoqërisë të dërgojë Ministrin Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, programin ekonomik-financiar dhe raportin për veprimtarinë ekonomiko-financiare të shoqërisë Ujësjetllës sh.a Divjakë .

Menjëherë

C.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrin të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 5,183,375 lekë** adresuar si më poshtë vijon:

I.Gjetje nga auditimi: *Katër Ujësjetllës sh.a respektivisht: Fier, Durrës, Elbasan-Qytet dhe Patos, pagesat e Këshillit Mbikëqyrës i kanë përlogaritur : Fieri dhe Durrësi mbi bazën e pagës sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë Ekonomisë në vlerën 131,500 lekë/muaj, Elbasan-Qytet mbi pagën e drejtorit të shoqërisë 120,000 lekë/muaj. Paga të cilat për secilin anëtar dhe kryetar të Këshillit Mbikëqyrës variojnë nga 26,000-39,000 lekë, kurse mbi bazën e pagës sekretarit të prefekturës variojnë nga 18,000-27,000 lekë/muaj duke përfituar më tepër secili anëtar 8,000 lekë/muaj dhe kryetari i Këshillit Mbikëqyrës 12,000 lekë/muaj. Pagesa këto në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” pika 6, ku përcaktohet se: Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës përfitojnë shpërblim për pjesëmarrje në Këshillat Mbikëqyrës si më poshtë vijon: c) Në shoqëritë anonime shtetërore jo strategjike vendore, për kryetarin, në masën 30 përqind të pagës mujore të sekretarit të përgjithshëm të prefekturës dhe për anëtarët e tjerë të*

Këshillit Mbikëqyrës, 20 përqind të kësaj page, duke shkaktuar **një dëm ekonomik në vlerën 3,631,305 lekë.**

II.Gjetje nga auditimi: Nga 56 Ujësjiellës sh.a, në shkallë vendi 44 Ujësjiellës sh.a i kanë paguar sekretarët e Këshillit Mbikëqyrës në masën 5,000 lekë/muaj, ndërsa 9 Ujësjiellës sh.a i kanë paguar më tepër, në kundërshtim me Udhëzimin e METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”, pika 5 ku përcaktohet se: Me propozim të Ministrit të METE-s (të autorizuarit e tij), këshilli mbikëqyrës, në mbledhjen e tij të parë..., mund të caktojë gjithashtu edhe një sekretar, me një shpërblim mujor deri në 15 000 lekë për shoqëritë strategjike dhe deri 5 000 lekë për ato jostrategjike. Sekretari i këshillit mbikëqyrës do të jetë përfaqësues i shoqërisë apo përfaqësues i METE-s.

Pagesa më tepër se udhëzimi i mësipërm janë kryer nga Ujësjiellës sh.a, respektivisht: Mirditë 46,000 lekë/muaj, Ura Vajgurore 18,000 lekë/muaj, Ujësjiellës sh.a Elbasan-Qytet 15,000 lekë/muaj, Patos 22.320 lekë/muaj duke e paguar njësoj me anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, në Ujësjiellës Fshat Korçë, Tepelenë, Pogradec dhe Sarandë nga 12,000 lekë/muaj dhe Elbasan Fshat 6,000/muaj. Nga përlllogaritjet e kryera rezultoi se për periudhën e auditimit 01.01.2013 viti 2014 deri 30.06.2015 nga pagesa e tepërta të sekretarëve të Këshillit Mbikëqyrës i është shkaktuar Ujësjiellësve sh.a një dëm ekonomik në vlerën **1,552,070 lekë.**

Të analizuarat për secilin Ujësjiellës sh.a janë si më poshtë:

1. Ujësjiellësi sh.a Fier në vlerën 1.440.278 lekë.

Gjetje nga auditimi: u konstatua se si pasojë e mos llogaritjes së pagave mbi përqindjen e pagës së sekretarit të përgjithshëm të prefekturës në masën 88,400 lekë, por mbi pagën prej 131,500 lekë të sekretarit të përgjithshëm të organeve qendrore sipas shkresës nr. 1211/1 datë 23.05.2013 të Ministrisë Ekonomisë dhe Energjetikës. Për periudhën nga data 01.01.2013 deri 30.06.2015 i është shkaktuar Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Fier, një dëm ekonomik prej **1.440.278 lekë** respektivisht:

-Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës në vlerën 345,228 lekë dhe 5 anëtarëve të tjerë në vlerën 1.095.050 lekë

Rekomandimi:Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Fier, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **1.440.278 lekë**, ndaj Këshillit Mbikëqyrës (Kryetar dhe 5 anëtarë) sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

2.Ujësjiellës sh.a Durrës në vlerën 421,589 lekë, si më poshtë:

Gjetje nga auditimi: u konstatua se si pasojë e mos llogaritjes së pagave mbi përqindjen e pagës së sekretarit të përgjithshëm të prefekturës në masën 88,680 lekë, por mbi pagën 109,000 lekë për të cilën nuk u paraqit ndonjë vërtetim se nga është marrë kjo pagë. Kjo pagë përkon me pagën e drejtorit të pronës Publike në ministrinë e Ekonomisë. Për pasojë për periudhën nga data 01.01.2013 deri 30.06.2015 i është shkaktuar Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Durrës, një dëm ekonomik prej **421,589 lekë**, respektivisht:

-Tre kryetarët e Këshillit Mbikëqyrës në vlerën 111.635 lekë dhe 8 anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikëqyrës në vlerën 310.224 lekë.

Rekomandim:Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Durrës, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën prej **421,589 lekë**, ndaj Këshillit Mbikëqyrës (2-ish Kryetar, Kryetar dhe 8 anëtarëve) sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

3.Ujësjiellësi sh.a Fush-Krujë në vlerën 246 713 lekë, si më poshtë:

Gjetje nga auditimi: u konstatua se janë kryer pagesa për 3 anëtarët të Këshillit Mbikëqyrës për periudhën nga 02.02.2015 deri më 16.06.2015, pa u pajisur me mandat emërimi, pasi mandatet e këtij Këshilli Mbikëqyrës sipas vendimit nr.4, datë 02.02.2012 të Kryetarit të Këshillit me objekt

“Emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës” kishin përfunduar më datën 02.02.2015, ndërkohë padrejtësisht ka vazhduar pagesa e tyre. Referuar listë pagesave për periudhën nga 02.02.2015 deri më 16.06.2015 rezulton se 3 anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë paguar padrejtësisht në vlerën 246,713 lekë.

Rekomandimi: Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime sh.a Fushë Krujë, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik ndaj 3 anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në vlerën 246,713 lekë, sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

4.Ujësjiellësi sh.a Elbasan-Qytet, në vlerën gjithsejt 741,895 lekë.

Gjetje nga auditimi: u konstatua se është ngarkuar njëherazi me detyrë arkiviste në Ujësjiellës sh.a Elbasan qytet edhe me detyrën e sekretares së Këshillit Mbikëqyrës duke lidhur kontratë dhe i paguar 15,000 lekë në muaj nga 5,000 lekë/muaj që duhej të paguhej, duke përfituar padrejtësisht vlerën 92,500 lekë.

Gjetje nga auditimi: Si pasojë e mos llogaritjes së pagave mbi përqindjen e pagës së sekretarit të përgjithshëm të prefekturës në masën 88,680 lekë, por mbi pagën e drejtorit të Shoqërisë prej 120,00 lekë, për periudhën nga data 01.09.2014 deri 30.07.2015 i është shkaktuar Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Elbasan Qytet, një dëm ekonomik prej **649,395 lekë**, nga e cila vlera prej 429,086 lekë pagë e përfituar tepër, ndërsa vlera prej 220,309 lekë, tatim në burim i pa llogaritur i pa ndalur dhe pa arkëtuar, në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, **si më poshtë:**

Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës vlerën 158,558 lekë, nga e cila vlera 103,356 lekë pagesë e tepërt dhe vlera prej 52,200 lekë, tatim në burim i pa llogaritur i pa ndalur dhe pa arkëtuar, sekretares së Këshillit Mbikëqyrës në vlerën 92.500 lekë dhe pesë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës respektivisht në vlerën 493.837 lekë.

Rekomandimi:Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Elbasan-Qytet, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik ndaj Këshillit Mbikëqyrës (Kryetar, sekretare dhe 5 anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës) në vlerën **741,895 lekë**, sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

5.Ujësjiellës sh.a Patos. në shumën 486,698 lekë:

Gjetje nga auditimi: u konstatua se në cilësinë e nënkryetares të Këshillit Mbikëqyrës në Ujësjiellës sh.a Patos, paga e saj është llogaritur dhe paguar në masën 22,320 lekë/muaj ose në masën 30% të pagës së sekretarit të përgjithshëm të prefekturës, (74,400 x 30%). Ndërkohë që duhet të llogaritet dhe paguhej në masën 20% (74,400x 20%) të kësaj page ose 14,880 lekë/muaj, duke u paguar tepër për 7,440 lekë në muaj (22,320-14,680) ose 7440 lekë/muaj x 22 muaj = **163,680 lekë** dëm ekonomik.

- me detyrë jurist në Bashkinë Patos, njëherazi është emëruar sekretar i Këshillit Mbikëqyrës (kur duhet të emërohej nga punonjësit e shoqërisë) i cili duhej të paguhej me pagën 5,000 lekë/muaj, ndërkohë që është paguar me pagën bruto prej 22,320 lekë/muaj, duke përfituar padrejtësisht për 22 muaj që i përket periudhës nga viti 2013,2014 dhe nga data 01.01.2015 deri 30.06.2015 duke shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e Shoqërisë Ujësjiellës Patos sh.a. në shumën prej **323,018 lekë**.

Rekomandim: Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Patos, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **486,698 lekë**, ndaj Këshilli Mbikëqyrës (sekretar i Këshillit Mbikëqyrës dhe anëtar) sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

6.Ujësjiellës sh.a Mirditë në vlerën 1,044,402 lekë

Gjetje nga auditimi: u konstatua se është emëruar sekretar i Këshillit Mbikëqyrës (kur duhet të emërohej nga punonjësit e shoqërisë) person me profesion mësues i papunë i cili duhej të paguhej me pagën 5,000 lekë/muaj, ndërkohë që është paguar me pagën bruto prej 46,000 lekë

lekë/muaj, duke përfitur padrejtësisht për 22 muaj që i përket periudhës nga viti 2013, 2014 dhe nga data 01.01.2015 deri 30.06.2015 duke shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e Shoqërisë Ujësjetllës Mirditë sh.a. në shumën prej **334,752 lekë**.

-Për vitin 2013 dhe periudhën e 9 mujorit Janar-Shtator 2014 janë paguar 2 ish-anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës pa zhvilluar asnjë mbledhje dhe mos informuar Ministrinë e Ekonomisë, duke mos mbajtur asnjë dokumentacion të funksionimit të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me VKM nr. 271, datë 09.05.1998 "Për miratimin e Statutit Tip të Shoqërive Anonime Shtetërore", ndryshuar me VKM nr.678, datë 03.10.2007 neni 20, pika 1, *ku përcaktohet se*; "Këshilli Mbikëqyrës mbledhet jo më pak se njëherë në 3 muaj në vit", duke përfitur padrejtësisht vlerën **709,650 lekë, respektivisht:**

1- ish-kryetar i Këshillit Mbikëqyrës, për *vlerën 425,790 lekë*, pasi nga shuma 458,865 lekë është zbritur shuma prej 33,075 lekë, respektivisht për muajin Gusht-22,410 lekë dhe Shtator 10,665 lekë, arkëtuar me mandat arkëtimin e Ujësjetllës sh.a. Mirditë nr. 2, datë 9.01.2015.

2- ish-anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës për *vlerën 283,860 lekë*, pasi nga shuma prej 305,910 lekë është zbritur shuma 22,050 lekë, respektivisht për muajin Gusht-22,410 lekë dhe Shtator 10,665 lekë, arkëtuar me mandat arkëtimin e Ujësjetllës sh.a. Mirditë nr. 2, datë 9.01.2015.

Rekomandim: Nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës sh.a Mirditë, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **1,044,402 lekë**, ndaj Këshillit Mbikëqyrës (Sekretari i Këshillit dhe 2 ish-antarëve të Këshillit Mbikëqyrës), sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

7.Ujësjetllës Ura Vajgurore sh.a, në vlerë 251,100 lekë.

Gjetje nga auditimi: u konstatua se punonjës auditi në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat, është emëruar anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Ujësjetllës Ura Vajgurore sh.a, por më pas ka dhënë dorëheqje nga ky pozicion për shkak të konfliktit të interesit duke përfitur padrejtësisht për 3 muaj vlerën prej **45,900 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 "Për funksionimin e Këshillave Mbikëqyrës", ndryshuar me VKM nr.677, datë 3.10.2007 dhe VKM nr. 215, datë 28.3.2012, pikën 5, ku përcaktohet se: Nuk mund të emërohen anëtarë të Këshillave Mbikëqyrës punonjës të organeve qendrore a vendore, që kryejnë funksione kontroll-revizioni.

- në detyrën e sekretares së Këshillit Mbikëqyrës, e papunë është paguar me të njëjtën pagë si të ishte anëtare e Këshillit Mbikëqyrës, ndërkohë që duhej të paguhej me 5,000 lekë/muaj. duke shkaktuar një dëm ekonomik buxhetit të Shoqërisë Ujësjetllës Ura Vajgurore sh.a në vlerën **205,200 lekë**.

Rekomandimi: Nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës sh.a Ura Vajgurore, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **251,100 lekë**, ndaj Këshillit Mbikëqyrës (sekretare e Këshillit Mbikëqyrës dhe anëtar) sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

8.Ujësjetllës sh.a Korçë Fshat në vlerën 134,000 lekë.

Gjetje nga auditimi: u konstatua se në detyrën e sekretarit të Këshillit Mbikëqyrës, i cili duhej të paguhej me pagën 5,000 lekë/muaj, ndërkohë që është paguar me pagën bruto prej 10,000 lekë/muaj, duke përfitur padrejtësisht për 22 muaj që i përket periudhës nga viti 2013, 2014 dhe nga data 01.01.2015 deri 30.06.2015 duke shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e Shoqërisë Ujësjetllës Korçë Fshat sh.a. në shumën prej 134,000 lekë.

Rekomandimi: Nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës sh.a. Korçë Fshat ndaj sekretarit të Këshillit Mbikëqyrës të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **134,000 lekë**, sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

9.Ujësjetllës sh.a Sarandë: në vlerën 151,200 lekë.

Gjetje nga auditimi: u konstatua se në detyrën e sekretares së Këshillit Mbikëqyrës me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr. 2, datë 16.05.2012, e cila duhej të paguhej me 5,000 lekë/muaj, ndërkohë që është paguar me 12,000 lekë/muaj ose tepër për 7.000 lekë/ muaj dhe për 24 muaj nga viti

2013,2014 dhe periudha 01.01.2015 deri 30.06.2015 është paguar padrejtësisht në vlerën neto pa tatimin mbi pagë prej **151,200 lekë**.

Rekomandimi:Nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës sh.a Sarandë ndaj sekretares së Këshillit Mbikqyrës, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **151,200 lekë**, sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

10.Ujësjetllësi sh.a Tepelenë, në vlerën 60,000 lekë.

-Gjetje nga auditimi: u konstatua se sekretari i Këshillit Mbikqyrës (kur duhet të emërohej nga punonjësit e shoqërisë) i cili duhej të paguhej me pagën 5,000 lekë/muaj, ndërkohë që është paguar me pagën bruto prej 12,000 lekë, /muaj, pasojë për 22 muaj që i përket periudhës nga viti 2013,2014 dhe nga data 01.01.2015 deri 30.06.2015, ka përfituar padrejtësisht shumën prej 60,000 lekë.

-Rekomandimi:Nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës sh.a Tepelenë, ndaj sekretarit të Këshillit Mbikqyrës të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **60,000 lekë**, sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

11.Ujësjetllësi sh.a Elbasan-Fshat në vlerën 27,000 lekë.

1.Gjetje nga auditimi:u konstatua se 2(dy) sekretare të Këshillit Mbikqyrës, janë paguar me pagë 6,000 lekë/muaj, kur duhej të paguheshin me 5,000 lekë/muaj, duke përfituar padrejtësisht **vlerën 27,000 lekë**,

-Rekomandimi: Nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës Elbasan-Fshat të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **27,000 lekë**, ndaj 2 sekretareve të Këshillit Mbikqyrës, sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

12.Ujësjetllësi sh.a Pogradec në vlerën 135,000 lekë.

Gjetje nga auditimi: u konstatua se sekretare e Ujësjetllës Kanalizime sh.a Pogradec, është emëruar sekretare e Këshillit Mbikqyrës e cila duhej të paguhej me pagën 5,000 lekë/muaj, ndërkohë që është paguar me pagën bruto prej 10 000 lekë/muaj, duke përfituar padrejtësisht për 30 muaj që i përket periudhës nga viti 2013,2014 dhe nga data 01.01.2015 deri 30.06.2015 duke shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e Shoqërisë Ujësjetllës sh.a. në Pogradec në shumën prej 135 000 lekë.

Rekomandimi:Nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a Pogradec, ndaj sekretares së Këshillit Mbikqyrës të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **135 000 lekë**, sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

13.Ujësjetllës sh.a Divjakë, në vlerën 43,500 lekë.

Gjetje nga auditimi: u konstatua se anëtare e Këshillit Mbikqyrës me detyrë specialiste e buxhetit në Drejtorinë e Financës në Ministrinë e Energjetikës, përveç se është paguar në masën 20% të pagës së Drejtorit të administrimit të pronës në Ministri ose me 21,140 lekë/muaj, padrejtësisht me vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 1, datë 28.06.2013, është paguar edhe si sekretare e Këshillit Mbikqyrës me 5,000 lekë/muaj, duke përfituar padrejtësisht shumën 43,500 lekë. Pagesë e cila bie në kundërshtim me VKM nr.678, datë 3.10.2007, "Për një shtesë në vendimin nr.271, datë 9.5.1998 të Këshillit të ministrave "Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore" neni 19,Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Mbikqyrës, pika 2 përcaktohet se: Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton këtij dhe pagën.

Rekomandimi:Nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a Divjakë, ndaj anëtares së Këshillit Mbikqyrës të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **43,500 lekë**, sipas cilësimit në pasqyrën 1 bashkëlidhur.

D. Mbi rastet e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private, adresuar në Inspektoratin e Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive Konfliktit Interesave (ILDKPKI)

Gjetje nga auditimi: Në Këshillat Mbikqyrëse të 8 Ujësjellsave 14 ish-Kryetarë Bashkie dhe Komune duke qenë në pozicionet e kryetarit të Bashkisë apo Komunës, njëherazi nga Asambletë e Aksionarëve apo Këshillat Bashkiake (kur ka qenë vetëm 1 aksionar), u evidentuan si raste që janë në gjendjen e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari. Kjo në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, neni 29 -Kufizimet për kryetarin e bashkisë, të komunës dhe të Këshillit të qarkut,shkronja a) ku përcaktohet se: Kryetarët e Bashkive dhe Komunave nuk mund të jenë Drejtues ose anëtarë të organeve Drejtuese të organizatave fitimprurëse, që ushtrojnë veprimtarinë brenda territorit të juridiksionit të tij.

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar më datën 02.03.2012 ndërmjet Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive përfaqësuar nga Kryeinspektori dhe ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" neni 8- Identifikimi i interesave private të zyrtarit nga persona të tretë, KLSH me shkresën nr. 527/176 datë 31.07.2015 i ka ofruar Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, informacionin për verifikim nëse janë në gjendjen e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari për 14 ish-Kryetarë Bashkie dhe Komune.

(Trajtuar hollësisht në faqet 185-187 të Raporti Përfundimtar të Auditimit)

Sa më sipër trajtuar sipas kërkesës KLSH, me shkresën nr. 3281/1 datë 04.09.2015, protokolluar në KLSH me nr. 527/193 datë 07.09.2015, ILKPD ka kthyer përgjigje se bazuar në shkronjën "gj" pika 1 të nenit 42 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005" Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar ILDKPKI, do të bëjë verifikimin dhe hetimin administrativ të konfliktit të interesave dhe në përfundim për masat e marra do të njoftohet KLSH.

E. Mbi papërgjeshmërinë dhe performancën e ulët të aktivitetit vendimmarrës të Këshillave Mbikqyrës.

Nga auditimet e ushtruara mbi veprimtarinë e shoqërive anonime dhe në veçanti aktivitetin vendimmarrës të Këshillave Mbikqyrëse në shoqëritë anonime, KLSH në vijimësi ka evidentuar inefficencën, formalitetin, dhe një sërë mangësish dhe shkeljesh të kuadrit rregullator ligjor, me impakt të drejtpërdrejtë performancën e ulët dhe keqadministrimin e këtyre shoqërive të cilat në jo pak raste kanë sjellë dëme ekonomike dhe abuzime të konsiderueshme me fondet publike.

KLSH në përfundim të auditimeve të kryera ka rekomanduar dhënien e masave disiplinore apo dhe zhdëmtimin e vlerave monetare të evidentuara. Papërgjegjshmëria dhe paligjshmëria vendimmarrëse e Këshillave Mbikqyrëse të shoqërive anonime shkon deri aty sa këto struktura marrin vendime kolegjiale për mos zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH me impakte të konsiderueshme financiare .

Sa më sipër argumentojmë:

Në auditimin e ushtruar në Albpetrol sh.a në vitin 2014, KLSH i ka rekomanduar, Këshillit Mbikqyrës dhe Administratorit të shoqërisë që në bazë të kompetencave të tyre ligjore të fillojnë procedurat për 24 Masa disiplinore nga të cilat 6 masa "Zgjidhje e kontratës së punësimit" dhe 18 masa " Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate". Nga verifikimi i kryer ka rezultuar që Këshilli Mbikqyrës nuk ka zbatuar rekomandimin e KLSH-së për zgjidhje kontrate punësimi për administratorin e shoqërisë.

Nga ana tjetër Administratori i shoqërisë nuk ka zbatuar rekomandimet që në bazë të kompetencave në cilësinë e administratorit duhet të fillonte procedurat për masat e tjera disiplinore.

Mjafton të përmendim faktin se nga ana e Këshillit Mbikqyrës të Albpetrol sh.a me Vendimin nr. 51, datë 17.10.2014 nuk është pranuar rekomandimi i KLSH-së me efekt rikuperimin e diferencës së rezultuar si pasojë e rritjes së paargumentuar të çmimit të kostos së transportit nga 3,7 në 9 USD/bbl, e cila deri më datë 30.06.2014 (datë në të cilën ka përfunduar dhe auditimi) është përlogaritur në vlerën **1,14 milionë USD**.

Në opinion të përgjithshëm konkludojmë se Këshillat Mbikqyrës me vendimmarrjet e tyre kolegjiale, favorizuese dhe arbitrare jo vetëm nuk luajnë një rol mbikqyrës me efekte rritjen e performancës së shoqërive anonime shtetërore por luajnë dhe rolin e “avokatit mbrojtës” ndaj administratorëve abuzivë dhe shkelësve të ligjit, dëshmi jo vetëm e mungesës së profesionalizmit por edhe papërgjegjshmërisë së këtyre organeve.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Luljeta Nano, Niko Nako, Koço Sokoli, Përparim Halili, Vjollca Selmani, Adela Sollaku, Blerin Shkurti, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Iliazi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.